



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Numri i lëndës: 2024:081217
Datë: 12.07.2024
Numri i dokumentit: 05934056

K.DH.SH.II.nr.345/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhoma e Shkalles se Dytë, me gjyqtaren Saranda Bogaj Sheremeti, ne çështjen juridike përmbarimore të kreditorit Inspektorati i Punës në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve – Inspektorati i Punës në Mitrovicë, kundër debitorit Kompania Rajonale e Ujësjiellësit “Mitrovica” SH.A., me NRB:704651041, me seli në Mitrovicë, me bazë juridike përmbarimore, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit, e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.1342/23 të datës 29.09.2023, me datën 12.07.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa e debitorit Kompania Rajonale e Ujësjiellësit “Mitrovica” SH.A., ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.1342/23 të datës 29.09.2023, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e ankimuar, KPPP.nr.1342/23 të datës 29.09.2023, në dispozitiv

të aktvendimit e ka refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitorit Kompania Rajonale e Ujësjetës "Mitrovica" SH.A., i paraqitur kundër Urdhrit Përbarimor P.nr.837/23 të datës 26.07.2023, të Përbaruesit Privat Atip Mustafa.

Kundër këtij aktvendimi, në afatin ligjor ka paraqitur ankesë debitori, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës përbarimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, dhe zbatimit të gabuar të drejtës materiale, me propozim që gjykata e shkallës së dytë ta aprovoj ankesën si të bazuar.

Dhoma e Shkallës së Dytë e Gjykatës Komerciale, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të dispozitës së nenit 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) e lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përbarimore (LPP), gjeti se:

-Ankesa e debitorit është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori Inspektorati i Punës në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve – Inspektorati i Punës në Mitrovicë, ka paraqitur propozim në bazë të dokumentit përbarimor- Vendimit të Inspektoratit të Punës, në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve, me numër 02Nr.22-132/2022 C, të datës 30.12.2022, me të cilin ka urdhëruar debitorin që të bëjë kompensimin e borxhit kryesor dhe shpenzimeve të përbarimit duke përfshirë edhe pagesën e kamatëvonesave në vlerë prej 8 % në vit në bazë të LMD-së.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor, ka kundërshtuar në tërësi urdhrin përbarimor për arsye se lënda është me padi në Gjykatën Komerciale – Departamentin Administrativ, ku është kërkuar Anulimi i Vendimit të Inspektoratit të Punës me numër 02Nr.22-132/2022 C i datës 13.12.2022. Andaj gjykatës i ka propozuar që propozimin për përbarim ta hedhë poshtë si të palejuar. Kreditori nuk ka parashtruar përgjigje në prapësim.

Kreditori i përbarimit nuk ka parashtruar përgjigje në prapësim, përkundër që i njëjti është njoftuar për të drejtën e tij për paraqitje të përgjigjes në prapësim me njoftimin e datës 20.04.2023.

Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e ankimuar pas vlerësimit të prapësimit ka nxjerrë aktvendimin KPPP.nr.1342/23 të datës 29.09.2023, me të cilin e ka refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitorit Kompania Rajonale e Ujësjellësit “Mitrovica” SH.A., i paraqitur kundër Urdhrit Përmbarimor P.nr.837/23 të datës 26.07.2023, të Përmbaruesit Privat Atip Mustafa.

Në arsyetim të aktvendimit gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar se Vendimi i Inspektoratit të Punës në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve, me numër 02Nr.22-132/2022 C, të datës 30.12.2022, i përmban të gjitha elementet e përcaktuara në nenin 27 paragrafin 1, sipas të cilit: *“Dokumenti përmbarimor është i përshtatshëm për përmbarim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit”*, pasi që i njëjti përmban të dhënat për kreditorin dhe debitorin, shumën të cilën e ka obligim ta paguaj debitori dhe kohën e përmbushjes së detyrimit.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Komerciale – Dhoma e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbarimore kur ka refuzuar prapësimin e debitorit të paraqitur kundër urdhrit të përmbaruesit privat, me të cilin është caktuar përmbarimi i propozuar nga kreditori.

Kjo gjykatë vlerëson se Vendimi i Inspektoratit të Punës, në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve, me numër 02Nr.22-132/2022 C, i datës 30.12.2022, është dokument përmbarues dhe i përshtatshëm për përmbarim, për faktin se me nenin 22 paragrafi 1 pika 1.2 të LPP-së, përcaktohet se: *“ Dokument përmbarues është edhe vendimi përmbarues i dhënë në procedurë administrative dhe aktpajtimi (me tej: ujdia)”* dhe përbënë bazën juridike për caktimin e përmbarimit sipas nenit 21, duke i plotësuar kushtet nga neni 24 paragraf 3 sepse, po ashtu është në pajtim edhe me nenin 27 paragraf 1 të LPP i cili përcakton se: *“Dokumenti përmbarimor është i përshtatshëm për përmbarim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit ”*, ndërsa një dokument përmbarimor për të shërbyer si titull përmbarues patjetër duhet të përmbajë elementet e përcaktuara me nenin 27 paragrafi 1, të cilat e bëjnë si dokument të përshtatshëm përmbarimor. Në bazë të këtij neni del se kushtet në fjalë duhet të plotësohen në mënyrë kumulative dhe se mungesa e vetëm njërit prej këtyre kushteve, e bënë dokumentin përkatës përmbarimor të papërshtatshëm për

përmbarrim. Me shikim në shkresat e lëndës konstatohet se Vendimi i Inspektoratit të Punës, në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve, me numër 02Nr.22-132/2022 C, i datës 30.12.2022, është dokument i përmbarrueshëm dhe i cili vendim është i plotfuqishëm dhe është i ekzekutueshëm nga data 20.06.2023, ashtu qe si i tillë është i vlefshëm juridikisht dhe i përshtatshëm për përmbarrim, pasi që i njëjti i plotëson të gjitha kushtet ligjore, ku në të është treguar kreditori dhe debitori, është përcaktuar saktë lartësia e detyrimit të debitorit, objekti, lloji, vëllimi dhe koha e përmbarrjes së detyrimit nga ana e debitorit.

Gjykata e shkallës së dytë ka vlerësuar edhe nenin 36 paragraf 1 të LPP - së, ku përcakton se “ *Së bashku me propozimin për përmbarrim, organit përmbarrues i dorëzohet edhe dokumenti përmbarrues origjinal apo kopje e vërtetuar, me klauzolën e përmbarrueshmërisë për përmbarrueshmëri* ”, ndërsa në paragrafin 2, të po këtij neni përcaktohet se “ *Vërtetimin për përmbarrueshmëri e jep Gjykata, respektivisht organi shtetëror që ka vendosur për kërkesën në procedurën e shkallës së parë* ”. Në rastin konkret kemi të bëjmë me vendim administrativ të formës së prerë, i njëjti është origjinal dhe si i tillë i plotëson kushtet për përmbarrim. Arsye këto nga te cilat edhe kjo gjykatë vlerëson se pretendimet e debitorit janë të paargumentuara dhe si te tilla mbeten vetëm ne natyrën deklarative, te pambështetura ne prova ashtu siç parasheh neni 69 par.4 i LPP, me çka nuk janë plotësuar as kushtet ligjore nga neni 71 te LPP.

Gjykata i vlerësoi pretendimet ankimore të debitorit se i njëjti ka parashtruar padi për hapjen e konfliktit administrativ mirëpo gjeti se të njëjtat nuk gjejnë mbështetje ligjore ngase në nenin 22 të Ligji Nr. 03/L-202 për Konfliktet Administrative, është përcaktuar se: “Padia nuk e ndalon ekzekutimin e aktit administrativ kundër të cilit është paraqitur përveç kur kjo me ligj është parashikuar ndryshe”. Andaj fakti se debitori ka parashtruar padi nuk paraqet pengesë për ekzekutimin e aktit administrativ në procedurën përmbarrimore.

Përndryshe, në procedurën përmbarrimore bëhet realizimi direkt i mbrojtjes juridike të konstatuar në dokumentin përmbarrimor i cili përmban aktin juridik me të cilin vërtetohet ekzistimi i kërkesës dhe se nga ky dokument rrjedh e drejta e organit përmbarrues që sipas propozimit të kreditorit të caktoj dhe zbatoj përmbarrimin.

Kompetenca e Dhomës së Shkalles së Dytë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK lidhur me nenin 17 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS,

Dhoma e Shkalles së Dytë

K.DH.SH.II nr.345/24 me datë 12.07.2024

Gjyqtarja,

Saranda Bogaj Sheremeti